

V E N D I M
Nr. 493, datë 19.9.2000

**PËR MËNYRËN E SHPËRNDARJES DHE TË PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE NGA
PRIVATIZIMI I NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS, FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20, të ligjit 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me ndryshimet përkatëse të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat nga privatizimi i ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë, të përdoren si më poshtë:

a. 5 për qind të përdoren nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, për përballimin e shpenzimeve për privatizimin e ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare.

b. 2 për qind të përdoren nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit për përballimin e shpenzimeve gjatë procedurave të tenderit dhe për shpërblimin e komisionit të vlerësimit të ofertave.

c. Ministrisë së Punëve Publike i kalohet fondi prej 125 200 000 lekësh, për kryerjen e pagesave të prapambetura, në masën 60 për qind të pagës mesatare, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 1999 dhe 1 janar – 31 gusht 2000. Pas kësaj date punonjësit që përfitojnë të trajtohen me pagesë papunësie, sipas legjislacionit në fuqi.

ç. Institutit të Sigurimeve Shoqërore i kalohet fondi prej 100 461 000 lekësh për pagesat e sigurimeve shoqërore për të gjithë punonjësit, për vitet 1997, 1998, 1999 deri 31.8.2000, brenda një muaji, nga arkëtimi i të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes.

2. Pjesa e mbetur e të ardhurave të siguruara nga privatizimi i ndërmarrjes, pas shpërndarjes sipas shkronjave a, b, c, dhe ç të pikës 1 të këtij vendimi, të derdhet në buxhetin e shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta